



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900176/5

Tiranë ___/___/2019

Lënda: Rekomandime për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të abuzuar/dhunuar seksualisht dhe të miturve në konflikt me ligjin.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

AGJENSISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

TIRANË

BASHKISË KAVAJË

KAVAJË

Të nderuar,

Më lejoni, që nëpërmjet këtij rekomandimi, institucioni i Avokatit të Popullit të ndajë me Ju qëndrimet, të cilat në të ardhmen, gjykojmë se do të përbëjnë disa nga sfidat kryesore në përmbushjen e detyrave dhe kompetencave ligjore në fushat e veprimtarisë shtetërore që Ju drejtoni, lidhur me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave në praktikë.

Nisur nga publikimi i rastit në mediat e shkruara dhe elektronike, lidhur me abuzimin seksual të minorenes me incialet XH.A., Avokati i Popullit kreu me iniciativë hetimin administrativ mbi këtë çështje. Për qëllime të hetimit në vlerësimin dhe analizimin e provave dhe fakteve mbi pretendimet e ngritura, u krijua një tjetër grup hetimor multidisiplinar, i përbërë nga një punonjës social dhe një jurist, udhëhequr nga parimet kryesore të paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë.

Metodologjia e hetimit administrativ është bazuar në:

Së pari, inspektimin në terren të të gjitha veprimeve të ndërmarra ose jo nga institucionet përgjegjëse në nivel vendor, konkretisht:

- institucioni i edukimit;
- zyra arsimore e qytetit Kavajë;
- komisariati i policisë Kavajë;
- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Bashkia Kavajë etj;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Së dyti, vlerësimin dhe analizimin e saktë të informacionit, provave, dokumentacionit dhe deklaratave të vëna në dispozicion nga institucionet e lartpërmendura veçmas, për të konstatuar dhe analizuar veprimet ose mosveprimet e ndërmarra nga ana e tyre.

Së treti, vlerësimi i hollësishëm i të gjitha provave së bashku, për të marrë rezultatin tërësor të hetimit administrativ.

Gjatë inspektimit në terren, institucionet kanë bashkëpunuar dhe nuk kanë treguar rezistencë ndaj institucionit tonë, por ajo që është vërejtur është fakti, se që të gjithë punonjësit e institucioneve të përfshira në këtë proces kanë patur ngarkesa emocionale të dukshme, si rezultat i ngjarjes së rëndë dhe trajtimit mediatik të rastit.

Veprimet dhe mosveprimet e përfaqësuesve të institucionit të edukimit parauniversitar

Ngjarja e ndodhur i ka përballur mësuesit me një situatë, e cila për nga natyra është e rëndë dhe sensitive. Zhvillimi i bisedave të kryera me mësuesen kujdestare, drejtuesin e institucionit të edukimit parauniversitar, psikologun dhe drejtuesin e zyrës arsimore Kavajë gjatë hetimit administrativ, është kryer me prezencën e të gjithëve dhe jo veç e veç, si rezultat i refuzimit nga ana e

tyre për të realizuar këtë proces në përputhje me metodologjinë e inspektimit sipas standardeve bashkohore.

Nga vlerësimi i informacionit të marrë nga biseda e zhvilluar me ta, kronologjia e ngjarjes në këtë institucion fillon me identifikimin në celularin e punonjësës sanitare të shkollës të mesazhit në adresën e instagramit të djalit të saj. Më pas, në datën 25.1.2019, pas mbarimit të orës së pestë të procesit mësimor dhe fillimit të orës së gjashtë, ngjarja vijon me referimin e këij mesazhi tek mësuesja kujdestare e klasës së djalit të sanitares dhe, njëkohësisht shok klase me nxënësen me inicialet XH.B.

Përmbledhja e veprimeve të kryera në këtë institucion, sipas kronologjisë së tyre, nga data 25.1.2019 - 28.1.2019, është pasqyruar më poshtë, referuar vetëm bisedës së zhvilluar, ndërmjet përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit dhe mësueses kujdestare, drejtuesit të institucionit të edukimit parauniversitar, psikologes së shkollës dhe drejtuesit të zyrës arsimore Kavajë.

Punëtorja sanitare e shkollës, menjëherë, pasi lexon mesazhin e dërguar nga nxënësi me inicialet L.L., në instagramin e nxënësit me inicialet K.A., djalit të saj (celularin e tij e mbante ajo), ku i kërkonte nxënësit me inicialet K.A., të gjente një vend, për të kryer marrëdhënie seksuale me nxënësen XH.B., nxënësi të të njëjtës klase, informon mësuesen kujdestare të kësaj klase, lidhur me përmbajtjen e mesazhit.

Gjatë zhvillimit të orës së gjashtë të mësimit, mësuesja kujdestare nxjerr nga klasa një e nga një, dy nxënësit, nxënësin me inicialet L.L., që kishte dërguar mesazhin dhe nxënësen me inicialet Xh.B., që ishte përmendur në mesazh. Qëllimi i zhvillimit të bisedave individuale me të dy nxënësit, qartazi tregon, se mësuesja kujdestare kërkonte të merrte informacion për të vërtetuar përmbajtjen e mesazhit.

Informacioni i marrë nga biseda e parë, e zhvilluar me nxënësin me inicialet L.L., ka konsistuar në faktin se, nxënësjja me inicialet XH.B., kërkon të lidhet me nxënësin me inicialet L.L., por ai nuk pranonte.

Gjatë bisedës së zhvilluar, ndërmjet mësueses kujdestare dhe nxënëses me inicialet Xh.B., pavarësisht rezistencës së saj, informacioni konsistonte në faktin se, nxënësjja me inicialet Xh.B. është në një lidhje dashurie me nxënësin me inicialet L.L., ku ka treguar se kryer edhe marrëdhënie seksuale me të. Në këtë bisedë, përmendet një “skrinshop”, por mësuesja nuk arrinte ta kuptonte se për çfarë bëhej fjalë.

Menjëherë, pasi mësuesja kujdestare bindet për vërtetësinë e mesazhit, informon drejtuesin e institucionit të arsimit parauniversitar dhe, në të njëjtën kohë edhe prindërit e nxënësit me inicialet L.L., për t'u paraqitur në shkollë.

Informacioni, për të cilën kishin dijeni mësuesja kujdestare dhe drejtoresha e shkollës ishte, që nxënësja me inicialet XH.B., kishte kryer marrëdhënie seksuale me nxënësin L.L., dhe, një “screenshot” që përmendet, por që nuk janë të qarta, se çfarë është. Informacioni i marrë nga mësuesja kujdestare, nga biseda e zhvilluar me nxënësen Xh.B., është mohuar nga nxënësi me inicialet L.L.

Nëna e nxënësit me inicialet L.L., së bashku me djalin e saj, mbasditen e datës 25.1.2019, kanë realizuar takimin me drejtoreshën e shkollës dhe mësuesen kujdestare në mjediset e shkollës, ku nxënësi me inicialet L.L., ka pranuar, që ka kryer marrëdhënie seksuale me nxënësen me inicialet XH.B., por “screenshot”-i që ndodhet në celularin e tij, është edhe në celularin e nxënësit me inicialet e L.M. Gjatë takimit, nëna e nxënësit L.L., ju ka kërkuar që kjo ngjarje të mos bëhet publike, se do të merrte masa për t'a transferuar djalin e saj në një shkollë tjetër.

Veprimi tjetër i ndërmarrë nga drejtuesi i institucionit dhe mësuesja kujdestare, pasi verifikuan vërtetësinë e aktit të kryer (nxënësi me inicialet L.L., pranon se ka kryer marrëdhënie seksuale me nxënësen me inicialet Xh. B.), ishte njoftimi i prindërve të nxënësit me inicialet L.M., i cili në celularin e tij dispononte një “screenshot” që përmendet disa herë edhe nga nxënësja me inicialet Xh.B., edhe nga nxënësi me inicialet L.L., por përsëri mësuesja kujdestare dhe drejtuesi i institucionit nuk e kuptojnë, se për çfarë bëhet fjalë.

Gjatë takimit të realizuar po në këtë datë (25.1.2019), ndërmjet prindërve të nxënësit L.M., ku prezent ishte edhe vetë nxënësi, mësuesja kujdestare dhe drejtuesi i shkollës informacioni që morën konsistente në faktin se, në këtë ngjarje ishin të përfshirë edhe nxënës të tjerë, pra “screenshot”-i ishte mjete i komunikimit, që përdorej për të shantazhuar vajzën, me qëllim që të kryente marrëdhënie seksuale edhe me nxënës të tjerë.

Nga takimet e realizuara, informacioni i marrë ishte i rëndë dhe, në kufijtë e të paimagjinueshmes për shoqërinë tonë. Për t'u përballur me atë çka kishte ndodhur, duhej të informonin prindërit e vajzës, konkretisht nënën e saj, pasi për babain ishin në dijeni që ndodhej në Itali.

Në mjediset e shkollës, në datën 25.1.2019, njoftuan që të paraqitej nëna e vajzës, shtetësja me inicialet S.B., së bashku me vajzën, si dhe psikologjen e këtij institucioni. Gjatë takimit, nxënësja me inicialet XH.B., në prezencë të

nënës së saj, psikologes drejtoreshës së shkollës dhe mësueses kujdestare, tregon në detaje historinë e dhimbshme të abuzimit seksual kundrejt saj nga nxënësit e tjerë. Në këtë takim, mësuesja kujdestare, psikologja e shkollës dhe drejtoresha e institucionit informuan nënën, se duhet të denonconin rastin në polici, por nëna ju kishte kërkuar kohë, me qëllimin për të informuar edhe bashkëshortin e saj, pasi kishte nenvojë për prezencën e tij gjatë kryerjes së këtij veprimi.

Nga data 25.1.2019 deri në datën 26.1.2019, janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me nënën dhe vajzën nga psikologja e shkollës, mësuesja kujdestare dhe drejtuesja e këtij institucioni, por nëna nuk kishte bërë asnjë veprim për të informuar bashkëshortin e saj.

Përpara këtij hezitimi nga ana e nënës, drejtoresha e shkollës informoi drejtuesin e zyrës arsimore Kavajë, për situatën e krijuar, ku ky i fundit i kërkoi që të merreshin masa për të realizuar një takim ditën e nesërme (datë 27.1.2019), ndërmjet nënës së nxënëses me inicialet XH.B., mësueses kujdestare, drejtoreshës së shkollës dhe psikologes.

Gjatë realizimit të këtij takimi, nënës ju bë e qartë, se si persona përgjegjës, të cilët janë në dijeni të rastit (mësuesja kujdestare, drejtoresha e shkollës, psikologja dhe drejtuesi i zyrës arsimore Kavajë), ata duhet të kryenin denoncimin në polici për rastin në fjalë. Nëna ishte psikologjikisht e rënduar dhe kërkoi që të mund ta ndihmonin për të njoftuar bashkëshortin e saj.

Në datën 27.1.2019, drejtuesi i zyrës rajonale arsimore Kavajë, ka informuar babain e vajzës, shtetasin me inicialet M.B., për ngjarjen e rëndë të ndodhur, si dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerreshin.

Babai i nxënëses me inicialet Xh.B., ka arritur në Kavajë në datën 28.1.2019, ku po në këtë datë është takuar me drejtuesin e zyrës arsimore Kavajë, drejtuesin e shkollës, mësuesen kujdestare dhe psikologun në mjediset e shkollës dhe, u ka kërkuar mbështetjen e tyre, për të kallëzuar në organet e drejtësisë veprën penale të abuzimit seksual të vajzës së tij. Drejtuesi i zyrës arsimore Kavajë ka telefonuar shefin e krimeve të Komisaritit Kavajë, ku e ka informuar mbi veprën penale të kryer ndaj nxënëses me inicialet Xh.B.

Telefonata e kryer, ndërmjet drejtuesit të zyrës arsimore Kavajë, shefit të Krimeve të Komisaritit Kavajë dhe shtetasit me inicialet M.B., është kryer rreth orës 19.00. Në vlerësim të veprimeve procedurale që duhet të kryeheshin dhe, kohës kur ishte venë në dijeni të rastit, shefi i krimeve të Komisaritit Kavajë, informoi babain për t'u paraqitur ditën e nesërme në këtë institucion

për të kryer veprimet procedurale në përputhje me ligjin nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Nga verifikimi i provave, në komisariatit e policisë Kavajë është dorëzuar një procesverbal i mbajtur në datën 28.1.2019, nga mësuesja kujdestare me inicialet M.B., psikologja e shkollës me inicialet N.K. dhe drejtuesi i shkollës 9-vjeçare me inicialet H.D., ku lidhur me ngjarjen e evidentuar kërkohet ndërhyrja e institucioneve përgjegjëse, konkretisht policisë së komisariatit të Kavajës dhe Zyrës Arsimore Kavajë.

Përmbajtja e procesverbalit pasqyron një përmbledhje të veprimeve të kryera, që në momentin kur punonjësja sanitare e shkollës i tregon mësueses kujdestare mesazhin e dërguar nga nxënësi me inicialet L.L., në telefonin e nxënësit me inicialet K.A., ku i kërkonte këtij të fundit një vend për të kryer marrëdhënie seksuale me nxënësen me inicialet Xh.B. në orën 12.45 të datës 25.1.2019 dhe, deri në çastin, që babai i nxënëses me inicialet Xh.B., kthehet nga Italia, paraqitet në shkollë, kontakton me drejtuesin e shkollës, mësuesen kujdestare dhe psikologjen dhe, i njofton se për ngjarjen që i ka ndodhur vajzës së tij, do t’a ndjekë personalisht vetë, në rrugë ligjore, mbasditen e datës 28.1.2019.

Gjithashtu, mësuesja kishte konstatuar, që javën e fundit të muajit janar, nxënësja me inicialet Xh.B., ka qenë e tërhequr dhe e mpirë, ku këtë konstatim e ka ndarë me nënën e vajzës në mbledhjen e prindërve.

Nxënësja me inicialet Xh. B., është 13 vjeç.

Përfundime

Gjatë vlerësimit dhe analizimit të veprimeve dhe mosveprimeve të kryera nga stafi i institucioneve të arsimit parauniversitar, janë marrë parasysh edhe faktorët e riskut, të cilët kanë ndikuar, si pozitivisht, ashtu edhe negativisht në realizimin e këtij hetimi administrativ, të tilla si: publikimi në media i rastit, ku stafi i këtij institucioni është ndjerë i sulmuar.

Më poshtë, pasqyrohet analiza e veprimeve të kryera nga punonjësit e institucionit të edukimit, nga çasti i identifikimit të rastit, menaxhimit të tij, aftësitë dhe njohuritë e punonjësve për të menaxhuar rastin sipas legjislacionin në fuqi dhe, ndikimi i veprimeve të kryera, gjatë trajtimit të këtij rasti delikat në interesin më të lartë të fëmijës, për të garantuar mbrojtjen e fëmijës.

Identifikimi i rastit nga mësuesja kujdestare, të dyshuar për abuzim seksual të fëmijës me inicialet XH.A., është udhëhequr nga eksperiencia e të qenit mësues,

por mentaliteti (për shkak edhe të natyrës delikate të ngjarjes – çështje të tilla ende vazhdojnë të konsiderohen tabu dhe të turpshme, çështje të dyerve të mbyllura), shkakton mosbesim dhe mospranim nga ana e saj, që ky fenomen ka ndodhur. Veprimet e kryera nga mësuesja kujdestare, tregojnë mospranimin e këtij fenomeni. Pikërisht, ky fakt e bën atë, që të zhvillojë biseda individuale me të dy nxënësit, veç e veç, për të vërtetuar vërtetësinë e asaj që kishte lexuar në përmbajtje të mesazhit.

Marrja dijëni për përmbajtjen e mesazhit të lexuar nga mësuesja, është identifikim i rastit (dyshim) të abuzimit me minorenen. Veprimi që duhet të kryente në përputhje me legjislacionin në fuqi¹ është raportimi i menjëhershëm i tij tek strukturat përgjegjëse e, konkretisht, tek drejtuesi i shkollës dhe drejtuesi i zyrës arsimore të qytetit, veprim të cilin e ka kryer tek drejtuesi i shkollës, por, pasi ka vërtetuar dhe është bindur, se përmbajtja e mesazhit është e vërtetë (nga bisedat e zhvilluara me nxënësit). Ndërkohë drejtuesi I zyrës arsimore është njoftuar më vonesë nga drejtuesi i shkollës.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sistemi arsimor parauniversitar garanton mbrojtje nga çdo formë veprimi që mund të shkaktojë dëm moral. Kështu, mospranimi i faktit dhe vonesa në zbardhjen e të vërtetës, janë veprime, të cilat, me apo pa dashje, shkaktojnë dëm moral tek fëmijët. Fëmijët e abuzuar seksualisht fajësojnë veten për veprimin e kryer, e identifikuar kjo edhe nga reagimi i nxënëses me incialet XH.A., e cila në fillimin e bisedës së zhvilluar me mësuesen kujdestare mohon gjithçka (nxënësjë me incialet Xh.B është vetëm 13 vjeç).

Në këtë frymë, neni 100/2 i Kodit Penal, parasheh se kryerja e marrëdhënieve seksuale me fëmijë të mitur, që nuk kanë arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç (kujtojmë se nxënësjë me incialet XH.B., është vetëm 13 vjeç), ose me të miturën, që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Përmbajtja e mesazhit të lexuar nga mësuesja kujdestare dëshmon elementë të veprës penale (i kërkohej një shokut të klasës, një ambjent për të kryer marrëdhënie seksuale me nxënësen me incialet XH.B., nga nxënësi me incialet L.L.).

Po kështu, neni 281, i Kodit të Procedurës Penale, detyron çdo nëpunës publik, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, kur marrin dijëni për një veprë penale, duhet të bëjnë kallëzim me shkrim në prokurori ose te një oficer i policisë gjyqësore.

¹ Pika 3, e nenit 67, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Nga verifikimi i provave të vëna në dispozicion, është kryer raportimi në Komisaratin e Policisë Kavajë, në datën 28.1.2019, por nga vlerësimi i përmbajtjes së procesverbalit të dorëzuar nga institucionet e edukimit në këtë komisarjat, nuk evidentohet në të, nëse këto institucione kanë identifikuar elementë të veprës penale, siç është kryerja e marrëdhënieve seksuale me fëmijë të mitur, që nuk kanë arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç (rikujtojmë, se nxënësja me inicialet XH.B., është vetëm 13 vjeç).

Nga analiza e provave dhe fakteve është konstatuar, se periudha kohore e kryerjes së raportimit tek strukturat përkatëse psh, Policia e Shtetit, është kryer tre ditë me vonesë. Konkretisht, punonjësit e institucionit të edukimit janë vënë në dijeni për ngjarjen e ndodhur në datën 25.1.2019, ndërsa njoftimi është kryer në datën 28.1.2019.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, është detyrim ligjor për raportimin e fëmijës në nevojë për mbrojtje, citojmë shprehimisht: “...mësuesi dhe ofruesi i shërbimit psiko-social shkollor (në rastin konkret psikologu i shkollës) kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës. Njësia arsimore vendore, në çdo rast, kur merr dijeni për fëmijë në nevojë për mbrojtje, bën raportimin te strukturat për mbrojtjen e fëmijës...”.

Gjatë analizës së provave për veprimet e kryera nga mësuesi kujdestar, psikologu, drejtuesi i shkollës dhe drejtuesi i njësisë arsimore vendore Kavajë, duket qartë, se detyrimi që kanë këta aktorë, në rastet kur konstatojnë dyshim apo ndodhi të abuzimit të fëmijës (në rastin konkret, fëmijës me inicialet Xh.B.), nuk është përmbushur. Struktura përgjegjëse, ku këta punonjës duhej të raportonin, është pikërisht Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Bashkisë Kavajë.

Gjithashtu, vërejmë, se në pikën 7, të nenit 67, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, është parashikuar se, procedurat për raportimin e rasteve rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës. Konstatojmë, se ky udhëzim, një akt nënligjor i rëndësishëm, nuk është miratuar ende, edhe pse afati ligjor brenda të cilit do të duhej të ishte miratuar ka kaluar (neni 71, i ligjit parasheh afatin 6 mujor).

Mbështetur në pikën 2, të nenit 69, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, konsiderohet kundërvajtje administrative, çdo mospërmbushje e detyrimeve ligjore (konkretisht, neni 67, i ligjit), nga strukturat e përcaktuara dhe punonjësit përkatës.

Pavarësisht, mospërmbushjes së detyrimit ligjor të përcaktuar në pikën 7, të nenit 67, të ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, për miratimin e udhëzuesit të përbashkët të procedurave të raportimit të rasteve të detyrimit për raportim të çdo rasti të dyshuar ose ndodhur të fëmijës së abuzuar, brenda afateve kohore të përcaktura në dispozitat ligjore, udhëzimi nr.10, datë 25.2.2015, katërministror “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”, përcakton detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat standarde për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse, për ofrimin e shërbimeve, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Në frymën e këtij udhëzimi², abuzim seksual është çdo veprim ose aktivitet seksual për përfitim ose kënaqësi seksuale të abuzuesit, pavarësisht nëse fëmija pranon ose jo. Abuzim seksual mund të jetë “me kontakt”, siç është përdhunimi, ose “pa kontakt”, si për shembull detyrimi ose inkurajimi i një fëmije për të parë apo për të qenë pjesë e komunikimeve apo materialeve me përmbajtje pornografike. Gjithashtu, edhe të gjitha abuzimet seksuale me kontakte fizike janë klasifikuar si raste me rrezik të lartë. Kjo nënkupton, se me rritjen e intensitetit të rrezikut ndaj fëmijës, rritet gjithashtu, edhe niveli i ndërhyrjes, ku në përputhje me përcaktimet e bëra në udhëzues, niveli tretësor individual nënkupton plan individual, ndërhyrje të hartuara për secilin fëmijë të abuzuar apo në rrezik. Aneksi 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, përmban udhëzime teknike të detajuara në lidhje me llojet e shfaqjes së abuzimit, shkaqet, shenjat dhe simptomat e abuzimit, përfshirë dhe shenja, që mund të shkëmbehen për keqtrajtime.

Po kështu, të gjithë aktorët e përfshirë në këtë udhëzues, kanë detyrimin ligjor për të vlerësuar edhe listën gjithëpërfshirëse të llojeve të ndryshme të sjelljeve të fëmijëve, për secilën kategori të abuzimit, ku pasqyrohet edhe abuzimi seksual. Për shkak të ndikimit afatgjatë, që ka mbi fëmijën ky abuzim, të gjitha veprimet konsiderohen automatikisht si abuzive edhe në ato raste, kur fëmija duket se nuk është dëmtuar.

Llojet e shfaqjes së abuzimit seksual janë të ndryshme, si psh: përfshirja e fëmijës në një aktivitet seksual me kontakt apo pakontakt, të cilin ai/ajo nuk e kupton mirë, nuk është në gjendje të japë aprovim të mbështetur në informacion ose nuk është përgatitur nga ana zhvillimore (p.sh. në rastin konkret, fëmija me inicialet Xh. B., është vetëm 13 vjeç dhe pretendohet sipas mesazhit që do të kryejë marrëdhënie seksuale me fëmijën me inciale L.L. dhe, për më tepër ky mesazh i dërgohet edhe një nxënësi tjetër). Pra, ashtu sikundër

² Udhëzimi nr. 10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

kuptohet, edhe vetë përmbajtja e mesazhit, drejtuar një nxënësi tjetër, përbën element të abuzimit seksual, sepse është thyer konfidencialiteti i një marrëdhënieje intime.

Gjithashtu, në ankesin 2, bashkëlidhur këtij udhëzuesi gjendet edhe formati standard i formës së referimit, që mësuesi, psikologu, drejtuesi i shkollës dhe drejtuesi i zyrës arsimore duhej të plotësonin për të referuar rastin, pasi kishin evidentuar llojin e abuzimit, i klasifikuar “rrezik i lartë”.

Në rubrikën 1, të kreut IV, të udhëzuesit nr.10/2015, procedurat për ndërhyrjen në ndihmë të fëmijëve në rrezik përcaktojnë edhe periudhën kohore të referimit/raportimit të rastit në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës nga momenti i identifikimit të tij.

Konkretisht, në zbatim të këtij udhëzimi, veprimet që duhet të kryenin punonjësit në rastin konkret, pas identifikimit të rastit me rrezikshmëri të lartë, janë plotësimi i formularit të referimit (aneksi 2), për t’ia raportuar Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës brenda 24 orëve nga identifikimi i rastit ose në ditën pasardhëse të punës.

Provat dhe faktet dëshmojnë, se ky udhëzim nuk është zbatuar nga punonjësit e institucioneve të edukimit në asnjë prej elementëve detyrues të tij. Për më tepër, insistimi i personelit të bërë takimin në grup me punonjësit e institucionit të Avokatit të Popullit dhe jo veçmas tregon për një strukturim të problemit dhe paraqitjen e qëndrimeve të konsoliduara që të çonë në mungesë transparence dhe përgjegjësisë personale. Mësuesit nuk kanë mundur të luajnë rolin e tyre në mbështetje të viktimës por janë ndjerë edhe vetë të viktimizuar.

Referuar informacionit të sipërpërmendur dhe nga vlerësimi krahasues, ndërmjet gjetjeve të këtij informacioni dhe detyrimeve ligjore, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, për veprimet që duhet të kryenin të gjithë aktorët në nivel qendror dhe vendor, është konstatuar nga institucioni ynë, se mungesa e informacionit mbi aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për mbrojtjen e fëmijës, ka penguar kryerjen e veprimeve për të mundësuar bashkëpunim, bashkërendim dhe koordinim të punës, ndërmjet strukturave përgjegjëse horizontale dhe vertikale, për të patur një qasje gjithëpërfshirëse në identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe integrimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës.

Veprimet dhe mosveprimet të strukturave të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës, Bashkia Kavajë

Nga intervistat e realizuara, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashkinë Kavajë nuk është njoftuar zyrtarisht nga Zyra Arsimore Kavajë, sipas formateve standarde dhe periudhës kohore, i parashikuar ky detyrim në udhëzimin nr.10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

Në vazhdimësi, nga vlerësimi i informacioneve të mbledhura dhe zhvillimi i intervistave të realizuara me psikologun e shkollës “Rilindja” dhe Punonjësën e Mbrojtjes së Fëmijëve, rezulton se kemi një njoftim për rastin në fjalë, nëpërmjet mjeteve të komunikimit (cel), që daton në 29.1.2019 (psikologjia e shkollës “Rilindja” njofton me anë të celularit Punonjësën e Mbrojtjes së Fëmijës).

Po kështu, nga vlerësimi i informacionit, punonjësja e shërbimeve sociale në Bashkinë Kavajë, në rrugë informale, në datën 1.2.2019, kishte dëgjuar për një informacion, se një vajzë nga shkolla 9-vjeçare është përdhunuar nga 8 nxënës. Për të vërtetuar informacionin e dëgjuar në rrugë informale, ajo kërkon të vihet në dijeni, duke komunikuar me punonjësën e policisë së Komisarariatit të Policisë Kavajë (informacioni kërkohet nëpërmjet mjeteve të komunikimit, cel). Ky punonjës nuk e dispononte këtë informacion, sepse pozicioni i punës së tij nuk e përfshinte veprimtarinë e fushës për mbrojtjen e fëmijës. Përfaqësuesit e AP-së konstatuan, se ky punonjës policie është ftuar për të marrë pjesë në takimin e Grupit Teknik Ndërsektorial, të datës 4.2.2019.

Nga provat e vëna në dispozicion, Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Kavajë është vënë në lëvizje për të kryer detyrat e saj funksionale, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në datën 3.2.2019, vetëm pas njoftimit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Menjëherë, ajo ka kontaktuar me Komisariantin e Policë Kavajë, ku është informuar se çështja është në prokurori për hetim dhe nuk mund t’i jepnin informacion, pra pasi rasti është bërë publik.

Në datën 4.2.2019, në orën 8.00, Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijës është paraqitur në shkollën 9-vjeçare “Rilindja”, për të kryer intervistat me mësuesen kujdestare, drejtoreshën e shkollës dhe nxënësen me incialet XH.B., e cila nuk ishte paraqitur në shkollë. Në vazhdimësi, ka kërkuar mbështetjen e drejtoreshës së shkollës për të mundësuar takim me babain e vajzës, i cili nuk ka pranuar. Theksojmë se e mitura nga data 25.1.2019 deri në datën 4.2.2019, e mitura me incialet Xh.B., ka zhvilluar mbi 4 takime me persona të ndryshëm.

Po në këtë datë, kjo punonjëse ka kërkuar mbledhjen e GTN (Grupi Teknik Ndërsektorial), ku ka njoftuar zëvendëskryetarin e Bashkisë Kavajë, z. Dorian

Gjuzi, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social, Zyrën Arsimore znj.Sonila Peza, drejtoreshën e shkollës 9-vjeçare znj.Hamide Qarri, psikologen e shkollës znj.Nerilda Kurti dhe punonjësën e policisë z.Faik Ruko.

Mbledhja e GTN është kryer në orën 16.30, në mjediset e shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, ku kanë marrë pjesë të gjithë të ftuarit, përveç përfaqësuesve nga Komisariati i Policisë Kavajë. Në takim ka marrë pjesë edhe kryetari i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, znj.Alma Tandili, si dhe stafi i saj mbështetës. Në përfundim të takimit janë marrë dy vendime, të cilat konsistojnë në realizimin e takimit me fëmijën me incialet XH.B. dhe prindërit e saj, në bashkëpunim me drejtoreshën e shkollës, si dhe puna bindëse për të punuar me babain e vajzës, për trajtimin e specializuar të saj.

Në datën 5.2.2019, Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijës, ka kontaktuar me drejtoreshën e shkollës për të zbatuar vendimin e marrë në mbledhjen e GTN, ku është informuar nga kjo e fundit, se babai i vajzës nuk pranon ndihmën e ofruar nga shërbimet sociale, si dhe do të shkonte personalisht në Tiranë, për mundësuar një trajtim të specializuar për vajzën.

Po në këtë ditë, shërbimet sociale të Bashkisë Kavajë, kanë shkuar në banesën e fëmijës me incialet XH.B., ku kanë kontaktuar me babain, i cili ka deklaruar me vullnet të lirë në një procesverbal, se nuk pranon ndihmën dhe mbështetjen e shërbimeve sociale dhe, mundësisht të qëndronin larg kësaj çështjeje.

Takimi i dytë i GTN, është realizuar në datën 6.2.2019, ku në këtë takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit. Në këtë takim u morën një sërë vendimesh për ngritjen e grupeve të punës, për mbështetjen e fëmijëve të shkollës 9-vjeçare “Rilindja” dhe, mandej në shkollat e tjera.

Përfundime

Për sa më sipër, si dhe në mbështetje të nenit 51, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ka për detyrë të identifikojë në mënyrë proaktive rastet e fëmijës në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet komunikimit me profesionistë nga sektori i arsimit, shëndetësisë dhe rendit, të cilët kanë kontakte me fëmijët.

Nga analiza e të gjitha veprimeve të ndërmarra për rastin në fjalë, nga punonjësit e sektorit të arsimit, rendit dhe vetë punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve është konstatuar komunikim i fragmentarizuar, bazuar në një qasje

individuale, jofunksionale në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Për rastin në fjalë, mbështetur në pikat “1”, “2” dhe “3”, të nenit 62, të ligjit nr.18/2017, përcaktohen qartë përgjegjësitë e strukturës së mbrojtjes së fëmijës dhe strukturave të tjera në nivel vendor, si: zyrës arsimore të qytetit dhe komisariatit të policisë, për të mundësuar mbrojtjen e fëmijës, viktimë e abuzimit.

Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të tij, kanë të drejtë të kenë akses në banesën e prindit apo të personit fizik, si dhe në rezidencën e personit juridik, të cilët janë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijës së identifikuar apo të raportuar si viktimë e abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunës. Kur, në bazë të rrethanave dhe fakteve është e nevojshme, strukturat e mbrojtjes së fëmijës kërkojnë mbështetje nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Mospjesëmarrja e përfaqësuesve të policisë të Komisarariatit të Policisë Kavajë, në takimin e parë të GTN, të datës 4.2.2019, passjell mosmarrjen e një vendimi të duhur në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, për të garantuar së pari mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijës me inicialet XH.B.

Nga analizimi dhe vlerësimi i veprimeve të kryera nga institucionet përgjegjëse të lartpërmenduar, konstatohet vonesë në veprimet e kryera. Gjithashtu, këto veprime janë të fragmentarizuara, jobashkëpunuese dhe, si rrjedhojë kanë passjellë dështimin në praktikë të zbatimit të legjisllacionit të mbrojtjes së fëmijës, si dhe mungesën e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve përgjegjëse, për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve në interesin më të lartë të tyre.

Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të saj ligjore, në lidhje me asistencën për menaxhimin dhe zgjidhjen e rastit në fjalë në nevojë për mbrojtje, si edhe bashkërendimin e punës të realizuar në terren, ka vepruar:

- **së pari**, për të mbrojtur fëmijën me inicialet Xh.B;
- **së dyti**, për të ofruar mbështetje në ofrimin e shërbimit për trajtimin e rastit.

Në vazhdimësi, Avokati i Popullit kërkon, që në zbatim të detyrimeve ligjore që agjencia ka, të kryhet një hetim administrativ lidhur me konstatimet, që

institucioni i Avokatit të Popullit i ka evidentuar si shkelje administrative në kuptim të ligjit nr.18/2017.

Veprimet dhe mosveprimet e Komisarariatit të Policisë Kavajë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

Në kuadër të hetimit administrativ në terren, për verifikimin e veprimeve apo mosveprimeve të organeve të hetimit dhe akuzës në nivel vendor, lidhur me rastin e abuzimit seksual të një vajze të mitur në qytetin e Kavajës, u realizuan takime në Komisariatin e Policisë Kavajë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Konkretisht:

- në komisariatin e Policisë Kavajë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë u zhvillua takim me z. Aljoshë Brokaj, shef i Komisarariatit dhe z. Edmond Pjetraj, zëvendësshef i Komisarariatit;
- në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës u realizua takim me drejtuesin e Prokurorisë, znj. Anita Jella, si dhe me prokurorin e çështjes, pjesë e Seksionit për të Mitur, znj. Oltiana Çifliku.

Në vijim, parashtrijmë rrethanat e faktit, bazuar në deklaratimet e palëve dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, lidhur me veprimet procedurale të kryera nga organet e hetimit dhe akuzës në nivel vendor, në përputhje me detyrimet ligjore, të parashikuara në ligjin nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe ligji për Policinë e Shtetit.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare për administrimin e drejtësisë penale për të mitur, në funksion të garantimit dhe të respektimit të interesit më të lartë të fëmijës në procesin penal, është miratuar një ligj i veçantë, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregullat procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër, që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Qëllimi i këtij ligji është që të garantojë një kuadër ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur, në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare, që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të tij. Qëllimi dhe fryma e këtij ligji, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës është se, pavarësisht rolit që ka i mituri në një proces penal, qoftë aktiv (në konflikt me ligjin), qoftë pasiv (viktimë apo dëshmitar), atij duhet t’i garantohet në mënyrë të posaçme

një proces ligjor i dedikuar, për të mos përkeqësuar traumën e përjetuar nga i mituri, si edhe duke nxitur dëshirën për edukim dhe riintegrim në shoqëri.

Rasti në fjalë, objekt i këtij hetimi administrativ është mjaft kompleks, pasi të dyja palët e përfshira në procesin penal, si pala e dëmtuar, ashtu dhe pala e akuzuar, janë të mitur. Për këtë arsye, në përmbushje të misionit kushtetues të institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut, e veçanërisht të drejtave të fëmijëve, me vëmendje maksimale në garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, është kryer një vlerësim i dyanshëm, për të evidentuar veprimet procedurale, të kryera nga organet e kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, si në rastin e të miturës së dëmtuar, ashtu edhe në rastin e të akuzuarve të mitur në konflikt me ligjin.

Rezulton, se ditën e hënë, më datë 28.1.2019, në orët e mbrëmjes, rreth orës 19:00, përgjegjësjë e Zyrës Arsimore Kavajë ka kontaktuar me telefon zëvendëshefin e Komisarariatit, z.Edmond Pjetraj, duke e vënë atë në dijeni për ngjarjen e ndodhur. Që atë natë, z. Pjetraj ka marrë kontakt me babain e vajzës, të cilin e ka takuar ditën e nesërme, datë 29.1.2019. Gjatë këtij takimi është realizuar një bisedë paraprake, për të garantuar prindin e të miturës viktimë dhe njëkohësisht dëshmitare, se ai duhet të kallëzonte ngjarjen dhe, se ajo do të ndiqej në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe parimin e konfidencialitetit, sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Pas garancisë, se çështja do të ndiqej në rrugë ligjore dhe rasti nuk do të bëhej publik, prindi i të miturës ka pranuar t'a çojë vajzën e tij në komisarariat për të kallëzuar ngjarjen.

Duke qenë se bëhej fjalë për një rast, në të cilin e dëmtuara ishte e mitur viktimë dhe njëkohësisht dëshmitare³, Komisaritati i Policisë Kavajë ka marrë kontakt me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Seksioni për të Mitur, për të kërkuar mbështetjen e tyre në kryerjen e veprimeve procedurale, Meqenëse, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk ka seksion të dedikuar për trajtimin e çështjeve penale me të mitur, prokurori i gatshëm ka shkuar në Kavajë, së bashku me psikologun e prokurorisë dhe avokatin e caktuar kryesisht.

Rreth orës 11:45 minuta të datës 29.1.2019, është paraqitur në Komisariatin e Policisë Kavajë e mitura, e shoqëruar nga nëna e saj, e cila në respektim të

³ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, pikat 5 dhe 6, të nenit 3.

5. "I mitur viktimë" është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një veprë penale;

6. "I mitur dëshmitar" është çdo person nën 18 vjeç, i cili mund të ketë informacion lidhur me veprën penale.

pikës 2, të nenit 42, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur⁴, ka bërë kallëzim në lidhje me ngjarjen e ndodhur, në prani të nënës, prokurores, mbrojtësit ligjor, psikologes dhe oficerit së policisë gjyqësore të Komisarariatit Kavajë.

E mitura është dërguar për ekspertim mjeko-ligjor pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore në Tiranë më datë 30.1.2019. Në kohën e kryerjes së hetimit administrativ nga institucioni i Avokatit të Popullit, na u konfirmua nga përfaqësuesit e Komisarariatit dhe të prokurorit të çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, se akti përfundimtar i ekspertimit ende nuk ishte zbardhur, ndërsa aktualisht ai është administruar nga ana e Prokurores që ndjek çështjen në Prokurorinë Durrës.

Pas marrjes së kallëzimit nga e mitura viktimë, nga ana e prokurorit të gatshëm janë lënë detyra me shkrim, lidhur me veprimet që do të kryheshin nga ana komisarariatit në vijimësi. Në zbatim të këtyre detyrave, u janë marrë deklaratime personave që mund të kishin dijeni për ngjarjen: mësueses kujdestare, psikologes së shkollës e drejtoreshës së shkollës. Më pas, janë marrë masat për identifikimin e shtetasve të dyshuar për këtë vepër penale.

Pasi është bërë identifikimi i personave të dyshuar, ka rezultuar se ata janë të mitur në konflikt me ligjin, në kuptim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur⁵. Këta shtetas janë thirrur për të deklaruar në cilësinë e personit nën hetim. Në përputhje me dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, konkretisht pikës 3, të nenit 77⁶ dhe, siç rezulton nga regjistri i dinamikës së veprimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë, më datë 30.1.2019, duke filluar nga ora 8:45 e në vijim janë paraqitur në Komisarariat për të deklaruar 9 persona, si vijon:

- E.A, lindur më 18.9.2003 (15 vjeç);
- M.A, lindur më 13.4.2005 (13 vjeç);
- K.K, lindur më 25.1.2002 (17 vjeç);
- K.M, lindur më 22.8.2004 (14 vjeç);
- F.M, lindur më 21.5.2002 (16 vjeç);
- E.M, lindur më 15.3.2004 (14 vjeç),

⁴ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, nëpikë 2 të nenit 42, “Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë/dëshmitar nën 14 vjeç”, parasheh se: “*...Pyetja e të miturit nën moshën 14 vjeç mund të bëhet vetëm me pëlqimin dhe në praninë e përfaqësuesit të tij ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij. Përfaqësuesi ligjor/procedural ka të drejtë të shprehë mendimin e tij për pyetjet që do t’i drejtohen të miturit...*”.

⁵ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, pika 4 e nenit 3 përcakton se: “*... “I mitur në konflikt me ligjin” është çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale...*”.

⁶ Pika 3, e nenit 77, të ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, parashikon shprehimisht se: “*...Ndalohet marrja në pyetje e të miturit gjatë natës, nga ora 22.00 - 8.00...*”.

- E.H, lindur më 09.10.2003 (15 vjeç);
- L.L, lindur më 08.10.2004 (14 vjeç);
- L.M, lindur më 14.7.2003 (15 vjeç).

Një nga të miturit e paraqitur për të deklaruar nën cilësinë e personit nën hetim (i mituri M.A), rezulton se nuk e ka mbushur ende moshën minimale për përgjegjësi penale, sipas nenit 12 të Kodit Penal⁷ dhe sipas pikës 4, të nenit 3 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për këtë arsye, siç rezulton nga komunikata e datës 30.1.2019, si edhe nga materialet procedurale të referuara me shkresën nr.394, datë 30.1.2019 pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, Seksionit për të Mitur (procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personi që po zhvillohen hetimet), ky i mitur nuk është marrë në pyetje në cilësinë e të miturit në konflikt me ligjin, për shkak se as në kohën e kryerjes së veprës penale dhe as në momentin e paraqitjes për deklaram, ai nuk ka mbushur moshën minimale për përgjegjësi penale.

Personat e tjerë të mitur, rezulton se e kanë mbushur moshën minimale për përgjegjësi penale sipas Kodit Penal dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pasi rezulton, se në kohën kur mendohet të jetë konsumuar vepra penale (nga muaji tetor i vitit 2018 e në vijim), ata kishin mbushur 14 (katërbëdhjetë) vjeç. Këta të mitur janë marrë në pyetje në cilësinë e personit nën hetim, në praninë e prindit/kujdestarit ligjor, psikologut dhe mbrojtësit ligjor, në përputhje me pikën 1, të nenit 49, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur⁸.

Ata janë larguar nga Komisariati i Policisë Kavajë rreth orës 16:00, me urdhër të zëvendësshefit të komisarariatit, në përputhje me afatin maksimal të kohëzgjatjes së lejuar për shoqërimin e personave për t'u pyetur në polici, sipas pikës 2, të nenit 109, të ligjit për Policinë e Shtetit⁹.

Po atë ditë, pra më datë 30.1.2019, Komisariati i Policisë Kavajë, me shkresën nr.394, datë 30.1.2019, i ka referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Seksionit për të Mitur, materialet procedurale për veprën penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni

⁷ Në nenin 12, të Kodit Penal, përcaktohet se: *“...Ka përgjegjësi penale personi, që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç...”*.

⁸ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, pika 1, e nenit 49, “Prania e detyrueshme në veprimet procedurale me të miturit”, parashihet se : *“...Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut. Nga ky rregull bëhet përjashtim vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe/ose në rastet e parashikuara lidhur me gjendjen e flagrancës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale...”*.

⁹ Ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në pikën 2, të neni 109, përcakton se : *“...Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë...”*.

100 i Kodit Penal, konkretisht procesverbalin e referimit të veprës penale, procesverbalin e kallëzimit nga e mitura, procesverbalin për kqyrjen e vendit të ngjarjes, vendimin për ekspertim mjekoligjor, procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personat ndaj të cilëve po zhvillohen hetime, procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për ngjarjen, procesverbal sekuestrimi, etj.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, Seksioni për të Mitur, më datë 31.1.2019, në përputhje me pikën 1, të nenit 244, të Kodit të Procedurës Penale¹⁰, ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, për 8 personat nën hetim, të mitur në konflikt me ligjin, të dyshuar për konsumimin e veprës penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal¹¹. Paragrafi 2 i dispozitës së nenit 100, në të cilën është kualifikuar kjo veprë penale, i referohet figurës së veprës penale të kryerjes së marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të mitur nën moshën 14 vjeç, në rrethana cilësuese si bashkëpunim, më shumë se një herë, me dhunë, me pasoja të rënda për shëndetin, etj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e investuar me kërkesë nga Prokuroria e këtij rrethi, me vendimin nr.26/1, datë 1.2.2019 ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” në përputhje me nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale¹², ndaj 8 personave të mitur: L.L, L.M, E.M, F.M, K.M, K.K, E.H, dhe E.A.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me urdhrin e datës 1.2.2019 “Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor me nr.26/1, datë 1.2.2019”, ka urdhëruar ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit penal nr.26/1 akti, datë 1.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në përputhje me nenin 466 të Kodit të Procedurës Penale¹³ dhe ka ngarkuar me ekzekutimin e këtij vendimi seksionin përkatës në Komisariatin e Policisë Kavajë.

¹⁰ Kodi i Procedurës Penale, në pikën 1, të nenit 244, përcakton shprehimisht : “...Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa...”.

¹¹ Kodi Penal, në pikën 2, të nenit 100, parasheh në mënyrë eksplicite se : “...Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm...”.

¹² Neni 238, i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se: “...Me vendimin e arrestit në burg, gjykata urdhëron policinë gjyqësore që ta kapë të pandehurin dhe t’a çojë menjëherë në një institut paraburgimi për të qëndruar aty në dispozicion të autoritetit procedues. Koha e paraburgimit llogaritet në caktimin e dënimit...”.

¹³ Kodi i Procedurës Penale, në nenin 466 të tij parashikon shprehimisht : “...Masat e sigurimit të urdhëruara nga gjykata, ekzekutohen nga prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin...”.

Urdhri i Prokurorisë për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, së bashku me shkurtimin e vendimit, i është përcjellë Komisarariatit të Policisë Kavajë me shkresën nr.308.prot., datë 1.2.2019 dhe ka mbërritur në sallën operative të Komisarariatit të Policisë Kavajë më datë 1.2.2019, rreth orës 17:30.

Nga çasti i administrimit të urdhrin të Prokurorisë për ekzekutimin e vendimit nr.261, datë 1.2.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, strukturat e Komisarariatit të Policisë Kavajë kanë organizuar punën dhe kanë marrë masa për ekzekutimin e këtij vendimi, në përputhje me pikën 1, të nenit 49, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur¹⁴ dhe me nenet 246/1 e 247/1, të Kodit të Procedurës Penale¹⁵. Për arsyet e kohëzgjatjes së ekzekutimit të urdhrin të Prokurorisë nga Komisarati i Policisë Kavajë, i jemi drejtuar zyrtarisht këtij të fundit. Nga përgjigja e këtij institucioni rezulton se pas dorëzimit të urdhrin të Prokurorisë pranë sallës operative të Komisarariatit është hartuar plani i masave nr. 22, datë 1.2.2019, në të cilin janë planifikuar detyra specifike për marrjen e informacionit për vendndodhjen e personave të mitur dhe saktësimin e banesave dhe mjediseve, që ata frekuentonin zakonisht dhe ekzekutimin e urdhrin të prokurorit. Sipas shpjegimeve të komisarariatit, janë kryer veprimet e nevojshme për mbajtjen nën vëzhgim të banesave gjatë natës, me qëllim kapjen e këtyre personave, njëkohësisht për të shmangur dekonspirimin e operacionit policor, duke mbajtur parasysh faktin se të tetë personat e mitur ishin në lidhje shoqërore dhe po ashtu edhe familjarët e tyre njiheshin me njeri-tjetrin.

Ditën e nesërme, datë 2.2.2019, në orën 07.00, është ndërhyrë njëkohësisht në të tetë banesat e personave të mitur dhe si rezultat u bë i mundur shoqërimi dhe arrestimi i 7 (shtatë) prej të dyshuarve, ndërsa 1 (një) prej tyre u shpall në kërkim, pasi nuk u gjet në banesë, si edhe prania e tij nuk është konstatuar gjatë vëzhgimit të kryer nga punonjësit e policisë.

Siç rezulton nga regjistri i të dhënave për personat e ndaluar, shoqërimi i 7 të miturve në Komisariat është kryer në periudhën kohore, nga ora 11:30 deri në

¹⁴ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, në pikën 1, të nenit 49, parasheh se : “...*Çdo veprim procedural i kryer në lidhje me të miturin bëhet në prani të mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe psikologut. Nga ky rregull bëhet përjashtim vetëm në rastet kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhe/ose në rastet e parashikuara lidhur me gjendjen e flagrancës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale...*”.

¹⁵ Kodi i Procedurës Penale, në nenin 246/1 parashikon se : “...*Oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe i bën të njohur të drejtën që të zgjedhë një mbrojtës, njofton menjëherë mbrojtjen e zgjedhur nga i pandehuri ose të caktuar kryesisht dhe mban procesverbal për të gjitha veprimet e kryera. Procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit...*”.

Po aty, neni 247/1: “...*Kur personi ndaj të cilit është marrë masa nuk gjendet, oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore mban procesverbal, në të cilin tregon kërkimet e bëra dhe ia dërgon atë gjykatës që ka dhënë vendimin...*”.

orën 13:30 dhe deri në dorëzimin e tyre në dhomat e sigurisë, ata kanë qëndruar në zyrat e OPGJ pranë Komisarariatit të Policisë Kavajë.

Me shkresën nr.394/1, datë 2.2.2019, Komisarati i Policisë Kavajë i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, materialet procedurale për veprimet e kryera për kapjen dhe ndalimin e shtetasve, në zbatim të urdhrimit të Prokurorisë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.26/1, datë 1.2.2019.

Më datë 4.2.2019 është zhvilluar seanca gjyqësore e radhës, me kërkues Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe objekt marrjen në pyetje të 7 të miturve në konflikt me ligjin, sipas nenit 248, të Kodit të Procedurës Penale¹⁶. Në përputhje me dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur (nenet 19, 20 e 49), kjo seancë gjyqësore është zhvilluar në prani të prokurorit, psikologëve, të miturve të arrestuar, mbrojtësve të tyre ligjorë dhe familjarëve të tyre. Në përfundim të seancës gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arrest me burg” për të 7 (shtatë) të miturit nën hetim, duke urdhëruar Prokurorinë pranë kësaj Gjykate për zbatimin e këtij vendimi.

Ashtu sikundër rezulton nga regjistri i të dhënave për personat e ndaluar, të miturit e arrestuar janë transferuar në I EVP Kavajë, më datë 4.2.2019, në zbatim të vendimit të gjykatës për vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arrest me burg”.

Në respektim të të drejtave të fëmijëve, në interesin më të lartë të tyre, si dhe në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat ligjore për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, lidhur me pasqyrimin dhe publikimin e ngjarjes së ndodhur, institucioni i Avokatit të Popullit reagon me shqetësim, për mënyrën, sesi është paraqitur në mediat vizive. Mediat nuk duhet të kishin publikuar elemente të tillë si, emrin e shkollës, pamje të transmetuara nga shkolla, emrin e të miturës, prindërve si dhe intervistat e realizuar me ta etj. Këto detaje janë në shkelje të plotë të legjislationit ndërkombëtar dhe atij të brendshëm. Gjithashtu, për raste kaq sensitive mediat duhet t’i referohen deklarimeve zyrtare të bëra publike nga institucionet përgjegjëse të administratës shtetërore, sidomos për çështjet penale kur janë të përfshirë edhe të mitur. Në këtë kuptim, mediat duhet të jenë të kujdesshme dhe të trajtojnë

¹⁶ Kodi i Procedurës Penale, në nenin 248 të tij, “Marrja në pyetje e personit të arrestuar”, parasheh se: “...Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Nëpërmjet marrjes në pyetje gjykata verifikon kushtet e zbatimit të masës së arrestit dhe nevojat e sigurimit. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës. Kur pyetja e të arrestuarit duhet të bëhet në gjykatën e një rrethi tjetër, gjykata kërkon që pyetja të bëhet nga një gjyqtar i asaj gjykate...”.

ngjarjen me më shumë profesionalizëm duke, u fokusur tek fenomenin dhe jo te rasti, i cili kishte filluar të hetohej nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës që nga data 30.1.2019.

Në përfundim, mbrojtja nga çdo formë e dhunës, neglizhencës e abuzimit seksual dhe forcimi i shëndetit fizik e emocional të fëmijëve nuk është vetëm një komponent kyç i promovimit të të drejtave të tyre, duke përfshirë interesin e tyre më të lartë, por ka edhe përparësi të jashtëzakonshme. Kjo u jep fëmijëve mundësinë më të mirë për të jetuar një jetë të shëndetshme dhe të përmbushur, të rriten për të qenë adultë të lumtur dhe produktivë, u mundëson të jetojnë fëmijërinë e tyre, por passjell përfitime shumë të mëdha edhe për shoqërinë.

Në këtë kuptim, në frymën edhe të legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës dhe administrimit të drejtësisë penale për të mitur, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga ministritë e linjës për informimin e të gjitha strukturave përgjegjëse për ushtrimin e detyrimeve dhe përgjegjësi në zbatim e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës dhe Kodit të Drejtësisë penale për të Miturit.
- Marrjen e masave për forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Marrjen e masave të duhura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për trajtimin më të gjerë të temës së abuzimit/dhunës seksuale në *curriculat* mësimore (konkretisht të lëndës së edukatës seksuale).
- Marrjen e masave nga Bashkia Kavajë, nëpërmjet Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, për organizimin e fushatave ndërjeggjësuese dhe edukative me prindërit dhe anëtarët e komunitetit, për mbrojtjen e fëmijëve në interesin më të lartë të tyre.
- Monitorimin në vijëmbështetje të punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrjen e masave konkrete nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura.
- Marrjen e masave për ngritjen e shërbimit të specializuar për fëmijët e dhunuar seksualisht, që do të thotë ngritjen e një qendre të posaçme e të specializuar, konfidenciale, ku në mënyrë të dedikuar ofrohen shërbime të specializuara për këta fëmijë, nga një grup profesionistësh, si:

psikolog, psikiatër, neuropediatër dhe punonjës social. Shoqëria civile, të gjithë aktorët që punojnë me fëmijët, por edhe e gjithë shoqëria duhet të ndërgjegjësojnë dhe advokojnë, që ekzistenca e kësaj qendre nuk mund të limitohet për shkak të pamjaftueshmërisë së buxheteve, por ajo është nevojë dhe domosdoshmëri.

- Marrjen e masave për trajnimin dhe kualifikimin e stafit në vazhdimësi, për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të viktimave fëmijë të abuzuar seksualisht në të gjithë fushat e veprimtarisë jetësore: arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, drejtësi, etj.
- Marrjen e masave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.18/2017 dhe të ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
- Marrjen e masave për ndryshimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive, për përcaktimin e rregullave më të detajuara, për sa i përket trajtimit të çështjeve të abuzimit/dhunës seksuale tek të miturit.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për miëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

AVOKAT I POPULLIT

Erinda BALLANCA